



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:109906
Datë: 13.11.2024
Numri i dokumentit: 06445835

C.nr.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Haxhi Xhemajli, në çështjen juridike kontestimore të paditësit, S.K nga K.P. kundër të paditurit, Spitali i Përgjithshëm Pejë me seli në Pejë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Labinot Panxha, me bazë juridike: kontest nga marrëdhënia e punës, në seancën e mbajtur më datë 07.11.2024, ndërsa përpiluar me datë 13.11.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET NË TËRËSI E PABAZUAR kërkesëpadi e paditësit S.K nga K.P, me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET i padituri Spitali i Përgjithshëm në Pejë, që paditësin S.K nga K.P ta kthej në pozitën Infermier i anestezionit në Shërbimin e Anestezionit pranë Spitalit të Përgjithshëm Pejë, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e marrjes se aktgjykimit nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi S.K, ka parashtruar padi në këtë gjykatë me datë ..., me bazë juridike, kontest nga marrëdhënia e punës. Përmes padisë, precizimit të saj me parashtrësën e datës ..., gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar që të DETYROHET i padituri Spitali i Përgjithshëm në Pejë, që paditësin S.K nga K.P ta kthej në pozitën Infermier i anestezionit në Shërbimin e Anestezionit pranë Spitalit të Përgjithshëm Pejë, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e marrjes se aktgjykimit nën kërcënim të përmbartimit. Ka shtuar se, në Spitalin e Përgjithshëm në Pejë punon nga viti ..., ndërsa deri në vitin ... ka punuar në pozitën infermier – teknik i anestezionit. Po ashtu ka theksuar se, pas një trajnimi të ndjekur në SHBA, është kthyer në Emergjencë si teknik i anestezionit dhe reanimacionit për trajnimin e stafit të Emergjencës në kuadër të Spitalit të Përgjithshëm në Pejë. Paditësi gjithashtu deklaroj se, deri në Qershor të vitit ... ka punuar në Emergjencën e Spitalit, përsëri në pozitën e teknikut të anestezionit dhe reanimacionit, ndërsa në Qershor të vitit ... është caktuar në pozitën UD i Drejtorit të

Administratës së Spitalit të Përgjithshëm në Pejë. I njëjti po ashtu theksoj se, një kërkesë të tillë e kam parashtruar me qëllim të shmangies së ndonjë konflikti në vendin e punës, andaj gjykatës i propozoj që kërkesëpadinë ta aprovoj në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

I autorizuari i palës së paditur me përgjigje në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesën e saj si të pabazuar, duke theksuar se, paditësi në asnjë moment nuk ka paraqitur prova përmes të cilave do të mund të vërtetonte se i janë shkelur të drejtat e tij nga ana e punëdhënësit – Spitalit të Përgjithshëm në Pejë. Ka shtuar se, paditësi ka të lidhur kontratën e punës për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës si Infermier i përgjithshëm, dhe jo si teknik i anestezionit dhe se lëvizjet nga një repart në tjetrin, nuk janë në kompetence të punëmarrësit por të punëdhënësit, ashtu siç është përcaktuar me ligjin bazik të punës. Në këtë rast, paditësi është njoftuar nga drejtoresha e infermierisë se kurdo që paraqitet nevoja do ta sistemoj në pozitën e teknikut të anestezionit, mirëpo aktualisht e njëjta ka vlerësuar se për arsye të mbarëvajtjes së punëve duhet të vazhdoj punën si Infermier i përgjithshëm në repartin e Emergjencës. Lidhur me këtë, i propozon gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar - specifikuar.

Paditësi në përgjigjen ndaj fjalës përfundimtare të të autorizuarit të palës së paditur ka theksuar se, nuk ka argumente që të me mbajnë në pozitën e tanishme si Infermier i përgjithshëm në Repartin e Emergjencës për faktin se është vendim i Odes së Infermiereve, Mamive dhe Profesionisteve tjerë Shëndetësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: OIK), për profilizim në lëmin e anestezionit për çka konsideroj se i plotësoj kriteret e përcaktuara me atë vendim.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e të provuarit i ka administruar këto prova: Kontratën e punës për kohë të pacaktuar, me numër protokollit ..., e datës ...; Licencën e punës e lëshuar nga OIK, e datës ...; Certifikatën mbi aftësimin profesional, e datës ...; Vendimi i OIK i datës ...; Njoftimin e Drejtorit ekzekutiv, i datës ...; Kërkesën drejtuar Drejtorit të Infermierisë së Spitalit të Përgjithshëm Pejë; si dhe Përgjigjen në kërkesë, e datës

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK), arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për arsye se:

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësi është aktualisht i punësuar në pozitën Infermier i përgjithshëm pranë Spitalit të Përgjithshëm në Pejë, një fakt të tillë gjykata e konstaton nga shkresat e lëndës, përkatësisht në bazë të kontratës së punës me kohë të pacaktuar me nr. numër protokollit ..., e datës ..., ku vërtetohet se paditësi ka themeluar marrëdhënie juridike të punës, duke u caktuar në detyrat e punës në vendin e punës, Infermier në Emergjencë.

Në këtë rast, kontestuese ishte se a i njihet e drejta palës paditëse për sistemin në pozitën infermier – teknik i anestezionit në Shërbimin e Anestezionit pranë Spitalit të Përgjithshëm në Pejë.

Në bazë të njoftimit të Drejtorit Ekzekutiv Dr. Fazli Shala, të datës ..., gjykata ka provuar faktin se paditësi nga data ..., sistemohet në kryerjen e punëve dhe detyrave të punës Infermier i përgjithshëm në Repartin e Emergjencës Internistike.

Në bazë të licencës së punës të datës ..., gjykata ka provuar faktin se, paditësi është licencuar Infermier i përgjithshëm/teknik i anestezionit nga ana e OIK.

Në bazë të Certifikatës mbi aftësimin profesional të punëtorit, gjykata ka provuar faktin se paditësi me datë ..., është aftësuar për anesteziat.

Po ashtu, në bazë të shkresës së paditësit drejtuar UD Drejtoreshës se Infermierisë Arigona Nikçi, gjykata ka vërtetuar faktin se, paditësi ka kërkuar që të transferohet në njësinë e anestezionit.

Në bazë të përgjigjes në kërkesën e paditësit të dërguar nga ana e UD Drejtoreshës se Infermierisë, gjykata ka provuar faktin se, nuk i është marr për bazë kërkesa për sistemim brenda njësisë së anestezionit me arsyetimin se nuk është paraqitur nevoja për teknik shtesë.

Gjykata për të vendosur lidhur me pretendimet e palës paditëse në këtë çështje juridike kontestimore, mori për bazë dispozitën e nenit 17 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, i cili përcakton se, *“I punësuari caktohet në vendin e punës, për të cilën ka lidhur Kontratë Pune,”* ndërsa në paragrafin 2 të të njëjtit nen parashihet se, *“Në rast të nevojës për ristrukturim apo organizim të ri të punës, i punësuari në pajtim me Kontratën e Punës mund të sistemohet në vend tjetër të punës që i përgjigjet përgatitjes profesionale, aftësisë së tij dhe nivelit të njëjtë të pagës, në pajtim me Kontratën e Punës,”* kurse me dispozitën e paragrafit 3 të këtij neni, shprehimisht është paraparë se, *“I punësuari sipas nevojës mund të sistemohet në punë nga një vend në një vend tjetër, tek i njëjti punëdhënës në pajtim me Kontratën e Punës, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratën Kolektive.”*

Nga ky përcaktim ligjor, gjykata vlerëson se, pala paditëse me nënshkrimin e kontratës së punës me punëdhënësin është pajtuar me vullnet të lirë sa i përket vendit të punës dhe kryerjes së punëve dhe detyrave të punës si infermier në repartin e emergjencës, dhe se ndërrimi i vendit të punës apo sistemi i tij në pozitën Infermier – teknik i anestezionit në Shërbimin e Anestezionit do të vinte në shprehje vetëm në rast të nevojës për një sistemim të tillë, dhe në pajtim me kontratën e punës. Për me tepër, kontrata është një akt individual e cila lidhet ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit, me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës në pajtim me ligj, dhe se veprimi ndryshe nga vullneti i deklaruar i palëve kontraktuese, do të kushtëzonte pëlqimin e dyanshëm të palëve nënshkruese, dhe në rastin konkret nevojën e punëdhënësit për një sistemim të tillë, por gjithnjë duke respektuar të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës.

Për me tepër, në bazë të nenit 7 të LPK, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë provat me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa me dispozitën e nenit 319 paragrafi 1 të LPK, parashihet se secila palë ndërgjyqëse, ka për detyrë t'i provoj faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta. Lidhur me këtë, pala paditëse me asnjë provë të vetme nuk ka arritur që të argumentoj të drejtën e tij siç ka pretenduar. Gjithashtu, i njëjti nuk ka arritur që të paraqet prova bindëse se në rastin konkret i është cenuar ndonjë e drejtë nga marrëdhënia e tij e punës me punëdhënësin, apo se ekziston nevoja që i njëjti të sistemohet në pozitën teknik i anestezionit në Shërbimin e Anestezionit.

Pas shqyrtimit të të gjitha provave prezente në lëndë, deklarimeve të palëve ndërgjyqëse dhe analizimit të bazës ligjore, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është në tërësi e pabazuar.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura me lartë dhe për arsye se, nuk është kompetencë dhe autorizim i gjykatës që të vendos për rregullimin e raporteve të brendshme midis punëmarrësit dhe punëdhënësit, ky autorizim i takon ekskluzivisht punëdhënësit, këtu Spitalit të Përgjithshëm në Pejë, përkatësisht organeve brenda këtij institucioni që të vendosin për mënyrën e organizimit, sistemimit dhe ri-sistemimit të të punësuarve në punë dhe detyra të caktuara të punës.

Gjykata me rastin e vendosjes mori për bazë të gjitha pretendimet e palës paditëse, mirëpo nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për arsye se me asnjë provë të vetme nuk ka arritur ta argumentojnë të kundërtën e asaj që është vërtetuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e të cilën gjë kanë qenë i detyruar ta argumentoj në kuptim të dispozitës së nenit 7 paragrafi 1, 319 paragrafi 1 dhe 322 të LPK.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata duke marr për bazë se palët ndërgjyqëse nuk i kanë kërkuar - specifikuar, vendosi duke u bazuar në dispozitën e nenit 450 të LPK, ashtu që, secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Nga arsyet e theksuara më lartë, si dhe duke u bazuar në nenin 17 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, dhe në harmoni me nenin 143, 7, 319 paragrafi 1, 322 dhe 450 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2024:109906, C.nr, 13.11.2024

Gjyqtari

Haxhi Xhemajli

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2024:109906
Datë: 13.11.2024
Numri i dokumentit: 06445835